

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PER VITIN 2024**

**LIGJ Nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Data e kërkesës</b>	<b>Objekti i kërkesës</b>	<b>Data e kthimit të përgjigjes (4)</b>	<b>Përgjigje</b>	<b>Mënyra e përfundimit të kërkesës</b>	<b>Tarifa</b>
<b>1</b>	16.01.2024	Kërkesë për informacion nga gazetari R.Hoxha, Ina Media, në lidhje faturen e arketimit për aktet e kërkuara bazuar në ligjin për të drejtën e informimit.	25.01.2024	Kthyer përgjigje lidhur me informacionin e kërkuar sa i përket faturës së pagesës lidhur me aktet e kërkuara.	Shqyrtuar, e plotë.	Pa pagesë, e-mail.
<b>2</b>	16.01.2024	Kërkesë për informacion lidhur me numri i grave të vrara gjatë periudhës 2000-2024? (Referuar nenit 79/c të Kodit Penal) nga S.Vatnikaj.	30.01.2024	Nga të dhënat e zyrës se regjistrimit, sa i përket viteve 2017-2023, për veprën penale parashikuar nga neni 79/c (ndaj grave), rezultojnë 8(tetë) çështje penale, numri I viktimave është 9(nëntë) (gra të cilat kanë humbur jetën).	Shqyrtuar.	Pa pagesë, e-mail.

3	31.01.2024	<p>Kërkesë për informacion në kuadër të ligjit "Për të drejtën e informimit" , kërkoj nga ana e institucionit tuaj informacion si më poshtë;</p> <p>-Sa çështje janë referuar nga policia për veprën penale " Prodhim dhe shitja e narkotikeve" për vitet 2018-2023?</p> <p>-Sa çështje janë mosfilluar nga ana e institucionit tuaj për veprën e mësipërme për vitet 2018-2023?</p> <p>-Sa çështje janë pushuar nga ana e institucionit tuaj për veprën e mësipërme për vitet 2018-2023?</p> <p>-Sa çështje janë dërguar për gjykim nga ana e institucionit tuaj për veprën e mësipërme për vitet 2018-2023? , nga gazetare A.Hoxha.</p>	13.02.2024	<p>Nga të dhënat e zyrës së regjistrimit ju informojmë se:</p> <p>Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezultojnë të dhënat si mëposhtë vijon:</p> <p>Vitet 2018-2023 rezultojnë të regjistruar gjithësej 495 procedime penale, nga të cilat 12 procedime penale janë mosfilluar , 116 procedime penale janë pushuar dhe 190 procedime penale janë dërguar në gjykim.</p> <p>Sa I përket të dhënave të ish Prokurorisë së Rrethit Lushnje, rezultojnë të dhënat si mëposhtë vijon:</p> <p>Vitet 2018-2023 rezultojnë të regjistruar gjithësej 124 procedime penale, nga të cilat 2 procedime penale janë mosfilluar , 46 procedime penale janë pushuar dhe 43 procedime penale janë dërguar në gjykim.</p>	Shqyrtuar.	Pa pages, e-mail.
---	------------	---	------------	--	------------	-------------------

4	13.02.2024	Kërkesë për informacion lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 79/c. Sa i përket viteve 1995-2023, nga KSHH.	16.02.2024	Nga verifikimet e kryera nga zyra e regjistrimit, sa i përket kërkimeve në regjistra elektronik nuk rezulton të jenë regjistruar raste për veprën penale parashikuar nga neni 109/c i K.Penal.	Shqyrtuar.	Pa pages, e-mailil.
5	25.03.2024	Kërkesë për informacion lidhur me veprat penale parashikuar nga kreu X, i K.P nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.	28.03.2024	Kthim përgjigje, nuk ka ndryshime nga përgjigja e dërguar me herët.	Shqyrtuar	Pa pages.
6	25.03.2024	Kerkesë për informacion lidhur me veprat penale për keqtrajtimin e kafsheve nga gazetare K.Muca Zeri News.	28.03.2024	Nga verifikimet kryera nga zyra e regjistrimit, gjate vitit 2023, jane referuar 6 ceshtje per vepren penale te keqtrajtimin te kafsheve nga te cilat: 3 jane mosfilluar gjate vitit 2023 dhe 3 jane regjistruar si procedime penale.  Sa I perket procedimeve penale ju informojme se:  1 procedim penal eshte pezulluar gjate vitit 2023, 1 procedim penal eshte pezulluar gjate vitit 2024, 1 procedim penal eshte ne hetim.	Shqyrtuar	Pa pages, e-mailil.
7	26.03.2024	Kërkesë për informacion lidhur me zjarrin e pyejeve në Pish Poro, nga gazetare I.Hoxha, Qendra Faktoje.	28.03.2024	Nga verifikimet e kryera nga zyra e regjistrimit ju informojme se duhet te saktesonin te dhenat per te	Shqyrtuar	Pa pages, e-mailil.

				identifikuar ngjarjen, pasi te dhenat e paraqitura ne kerkese jane te pamjaftueshme per identifikimin.		
8	11.04.2024	Kërkesë për informacion lidhur me vrasjet ndaj grave në Janar 2021-Mars 2024 nga Avokati Popullit.	25.04.2024	Nga verifikimet e kryera nga zyra e regjistrimit rezultojnë 5(pesë) procedime penale, sa i përket periudhës Janar 2021- Mars 2024, në lidhje me vrasjet ku viktimat kanë qënë vajza/gra, nga të cilët , 1(një) procedim penal është pushuar, 2(dy) procedime penale janë dërguar në gjykim dhe 2(dy) procedime penale rezultojnë në hetim.	Shqyrtuar	Pa pages.
9	18.04.2024	Kërkesë për informacion lidhur me shtetasin R.S, nga Ina Media.	30.04.2024	Kthyrë përgjigje me shkresën nr. dt.,22.12.2023.	Shqyrtuar	Pa pages, email.
10	18.04.2024	Kërkesë për informacion lidhur me shtetasin A.S, nga Ina Media.	30.04.2024	Kthyer përgjigje me shkresën nr. dt., 22.12.2023.	Shqyrtuar	Pa pages, email.
11	01.05.2024	Kërkesë për informacion, sa i përket mosdeklarimit të ardhurave në kufijë, nga 2020-2023, nga gazetare A.Hoxha.	10.05.2024	Nga verifikimet e kryera rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka të regjistruar sa i përket vitit 2023, 1(një) procedim penal parashikuar nga neni 179/a, i Kodit Penal, i cili i është dërguar për kompetencë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të	Shqyrtuar	Pa pages, email.

				Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.		
12	01.05.2024	Kërkesë për informacion lidhur me vjedhjen e Kishes Karavasta , Viti 2004, ,Kishen Shen Kolli 2007, Muzeu Mk 20211, nga Media Amfora.	15.05.2024	Nga verifikimet e kryera nga zyra e regjistrit ju informojme se, është i pamundur verifikimi bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga ana juaj.	Shqyrtuar	Pa pages, e-mail.
13	02.05.2024	Kërkesë për informacion lidhur me ngjarjen e ndodhur lidhur me sekuestrimin e veprave te artit në datë 19.12.2023, Media Amfora.	17.05.2024	Lidhur me kërkesën ju informojmë se , Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka regjistruar procedimin penal nr.1239, viti 2023 për veprën penale “Trafikimi i veprave të artit dhe të kulturës”, parashikuar nga neni 138/a/2, i Kodit Penal. Në kuadër të këtij procedimi janë kryer veprime hetimore. Hetimet për këtë procedim nuk kanë përfunduar ende dhe për shkak të sekretit hetimor nuk mund të paraqesim informacion më të detajuar.	Shqyrtuar	Pa pages, e-mail.
14	10.05.2024	Kërkesë për informacion lidhur me procedimet bazuar në Operacionin Tempulli .	31.05.2024	Nga te dhenat e verifikuara nga zyra e regjistrit, ju informojme se:  Rezultojne 51(pesdhjete e nje) procedime penale, nga te cilat 10(dhjete) procedime	Shqyrtuar	Pa pages, e-mail.

				penale jane derguar per gjykim, 2(dy) procedime penale jane derguar gjykates me kerkesen per pushim, 1(nje) kallezim penal eshte mosfilluar.		
15	23.05.2024	Kërkesë për informacion lidhur me ngjarjen e ndodhur X, në Lushnje publikuar ne Emisionin Stop.	31.05.2024	“Në përgjigje të emaili-t tuaj të datës 23.05.2024, ku kërkoni informacion në lidhje me rastin X , ju bëjmë me dije se: Mbi bazën e materialeve të referuara nga Komisarati i Policisë Lushnjë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, pas kryerjes së procesit të shortimit dhe caktimit të prokurorit të çështjes, në datën 17.05.2024, ka regjistruar procedimin penal nr. 714, të vitit 2024, në ngarkim të të dyshuarit L.T, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “ <i>Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura</i> ”, parashikuar nga neni 102/1 i Kodit Penal.	Shqyrtuar	Pa pages, e-mail.